

**LIGJ**  
**Nr. 58/2019**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR MBROJTJEN SHOQËRORE  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KANADASË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.9.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11288, datë 26.9.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**MARRËVESHJE**  
**PËR MBROJTJEN SHOQËRORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
KANADASË**

Republika e Shqipërisë dhe Kanadaja (Palët),  
*të vendosura për të bashkëpunuar në fushën e mbrojtjes shoqërore,*  
*kanë vendosur të lidhin për këtë qëllim një marrëveshje, dhe*  
*kanë rënë dakord si më poshtë:*

**PJESA I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

“Përfitim, për secilën Palë, nënkupton çdo përfitim në para që është i pagueshëm sipas legjislacionit të asaj pale dhe që përfshin çdo shtesë apo rritje të këtij përfitimi në para;

“Autoritet kompetent”, nënkupton:

- për Republikën e Shqipërisë (Shqipëria), ministri ose ministrat përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të Shqipërisë; dhe

- për Kanadanë, ministri ose ministrat përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të Kanadasë;

“Institucion kompetent”, nënkupton:

- për Shqipërinë, institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit; dhe,
- për Kanadanë, autoriteti kompetent;

“Periudhë e vlefshme” nënkupton:

- për Shqipërinë, një periudhë kontributesh ose periudhë e barasvlershme sipas legjislacionit shqiptar; dhe

- për Kanadanë:

a) një periudhë kontributesh sipas Planit Kanadez të Pensioneve;

b) një periudhë gjatë së cilës paguhet një pension invaliditeti sipas Planit Kanadez të Pensioneve; ose

c) një periudhë rezidence sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit;

“Legjislacioni”, për secilën Palë, nënkupton ligjet dhe rregulloret e referuara në nenin 2.

2. Termi i përdorur në legjislacion dhe që nuk është përcaktuar në këtë nen ka kuptimin që i është dhënë në atë legjislacion.

## Neni 2

### **Hapësira ligjore**

1. Kjo marrëveshje zbatohet sipas legjislacionit në vijim:

a) për Kanadanë:

i. Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit dhe rregulloret e tij; dhe,

ii. Planit Kanadez të Pensioneve dhe rregulloret e tij;

b) për Shqipërinë:

Ligjeve mbi sigurimin shoqëror të detyrueshëm, rregulloreve dhe rregullave në lidhje me përfitimet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjare.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për çdo ligj dhe rregullore që ndryshon, shton, konsolidon ose zëvendëson legjislacionin e referuar në paragrafin 1.

3. Kjo marrëveshje zbatohet, gjithashtu, për çdo ligj dhe rregullore që zgjeron legjislacionin e njëjës Palë për të përfshirë një kategori të re personash ose përfitim të ri, përveç nëse Pala që zbaton ndryshimet informon Palën tjetër brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e atyre ligjeve dhe rregulloreve, se kjo marrëveshje nuk zbatohet për kategorinë e re të personave ose për përfitimin e ri.

## Neni 3

### **Hapësira personale**

Secila Palë do ta zbatojë këtë marrëveshje për çdo person i cili është apo ka qenë subjekt i legjislacionit shqiptar apo kanadez, ose i të dyja palëve, dhe për çdo person tjetër që fiton të drejtën për përfitime nga personi i parë sipas legjislacionit të njëjës prej Palëve.

## Neni 4

### **Trajtimi i barabartë**

Secila Palë siguron se çdo person i cili është apo ka qenë subjekt i legjislacionit të Palës tjetër, dhe çdo person të cilit mund t'i rrjedhin përfitime nga personi i parë, është subjekt i detyrimeve dhe ka të drejtën për çdo përfitim të dhënë nga legjislacioni i Palës së parë, në të njëjtat kushte si shtetasi i palës së parë.

## Neni 5

### **Eksportimi i përfitimit**

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, njëra palë nuk e redukton, ndryshon, pezullon apo fshin një përfitim të pagueshëm për një person, siç përshkruhet në nenin 3, bazuar vetëm në faktin se personi është rezident apo është i pranishëm në territorin e palës tjetër. Pala paguan përfitimin kur personi është rezident apo është i pranishëm në territorin e palës tjetër ose në territorin e një shteti të tretë.

2. Për Kanadanë, një kompensim ose shtesë e garantuar të ardhurash janë të pagueshme për një person që është jashtë Kanadasë, vetëm nëse Akti i Sigurimeve për të Moshuarit lejon që përfitimi të paguhet.

## PJESA II DISPOZITA NË LIDHJE ME LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM

### Neni 6

#### **Rregulla të përgjithshme për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar**

Në bazë të neneve 7 deri në 10:

a) një person i punësuar, i cili punon në territorin e njëres Palë është, në lidhje me atë punë, subjekt vetëm i legjislacionit të asaj Pale;

b) një person i vetëpunësuar, i cili banon në territorin e njëres Palë dhe i vetëpunësuar në territorin e të dyja Palëve është, në lidhje me atë punë, subjekt vetëm i legjislacionit të Palës së Parë;

c) një person i vetëpunësuar, i cili banon në territorin e njëres Palë dhe i vetëpunësuar në territorin e Palës tjetër për një periudhë maksimale prej 12-muajsh është, në lidhje me atë punë, subjekt vetëm i legjislacionit të Palës së Parë. Të dyja palët duhet të japin pëlqimin nëse periudha shtrihet më tepër se 12 muaj.

### Neni 7

#### **Përrjashtimet**

Nëse një person i punësuar, i cili është subjekt i legjislacionit të njëres Palë, dërgohet nga punëdhënësi i atij personi të punojë në territorin e Palës tjetër, ky person është, në lidhje me atë punë, subjekt vetëm i legjislacionit të Palës së Parë, sikur ajo punë të ishte kryer në territorin e Palës së Parë. Kërkohet pëlqimi i të dyja Palëve për të shtrirë përrjashtimin përtej një periudhe prej 24-muajsh.

### Neni 8

#### **Ekuipezhet e anijeve dhe të avionëve**

Një person, i cili është subjekt i legjislacionit të të dyja Palëve, për punësim si anëtar i ekuipezheve të një anijeve ose avioni duhet që, në lidhje me atë punësim, të jetë subjekt vetëm i legjislacionit kanadez, nëse personi banon në territorin e Kanadasë. Në çdo rast tjetër, ai person do të jetë subjekt vetëm i legjislacionit shqiptar.

### Neni 9

#### **Punësimi shtetëror**

1. Dispozitat e mbrojtjes shoqërore të Konventës së Vjenës, të 18 prillit 1961, për marrëdhëniet diplomatike dhe të Konventës së Vjenës, të 24 prillit 1963, për marrëdhëniet konsullore, vazhdojnë të jenë të zbatueshme, pavarësisht kësaj marrëveshjeje.

2. Një person i punësuar nga qeveria e njëres Palë, i cili është dërguar nga ajo Palë të punojë në territorin e Palës tjetër, është subjekt vetëm i legjislacionit të Palës së Parë në lidhje me atë punësim.

3. Përveç kur parashikohet nga paragrafët 1 dhe 2, një person, i cili është rezident në territorin e një Pale dhe është punësuar në atë territor nga qeveria e Palës tjetër dhe në lidhje me atë punësim, është subjekt vetëm i legjislacionit të Palës së Parë.

#### Neni 10 **Përfshirje**

Palët, me pëlqim të ndërsjellë, mund të ndryshojnë zbatimin e neneve 6 deri në 9 në interes të ndonjë personi apo kategorie personash.

#### Neni 11 **Mbulimi dhe rezidenca sipas legjislacionit të Kanadasë**

1. Për qëllime të llogaritjes së një përfitimi sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit:

a) nëse, gjatë ndonjë periudhe të pranisë apo banimit në Shqipëri, një person është subjekt i Planit Kanadez të Pensioneve ose të ndonjë plani gjithëpërfshirës pensionesh të një province të Kanadasë, ajo periudhë për atë person do të konsiderohet si periudhë banimi në Kanada; Kanadaja do të konsiderojë, gjithashtu, që kjo periudhë do të konsiderohet si periudhë banimi në Kanada për bashkëshortin e personit, për partnerin e njohur me ligj dhe personat në ngarkim që banojnë me atë person dhe të cilët nuk janë subjekt i legjislacionit shqiptar për arsye punësimi apo vetëpunësimi;

b) nëse një person është subjekt i legjislacionit shqiptar gjatë një periudhe pranie ose banimi në Kanada, Kanadaja do të vendosë nëse ajo periudhë, për atë person dhe për bashkëshortin e personit, për partnerin e njohur me ligj dhe personat në varësi që banojnë me atë person do të konsiderohet periudhë banimi në Kanada, në përputhje me dispozitat e Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit.

2. Për qëllimet e paragrafit 1:

a) Kanadaja do të konsiderojë që një person është subjekt i Planit Kanadez të Pensioneve ose i ndonjë plani gjithëpërfshirës pensionesh të një province të Kanadasë, gjatë një periudhe të pranisë ose banimit në Shqipëri vetëm nëse gjatë asaj periudhe, ai person paguan kontributet sipas atij planit për shkak të punësimit apo të vetëpunësimit;

b) Kanadaja do të konsiderojë që një person është subjekt i legjislacionit shqiptar gjatë një periudhe të pranisë ose banimit në Kanada vetëm nëse gjatë asaj periudhe, ai person paguan kontributet e detyrueshme sipas atij legjislacioni për shkak të punësimit apo të vetëpunësimit.

### PJESA III DISPOZITAT NË LIDHJE ME PËRFTITMET

#### KAPITULLI 1 BASHKIMI

#### Neni 12 **Periudhat sipas legjislacionit shqiptar dhe kanadez**

1. Nëse një person nuk ka të drejtën për një përfitim për shkak të periudhave të vlefshme, të pamjaftueshme sipas legjislacionit të një Pale, atëherë ajo Palë do të përcaktojë të drejtën e atij personi për përfitim, duke mbledhur periudhat e vlefshme dhe periudhat e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, me kusht që këto periudha të mos mbivendosen.

2. Për të përcaktuar të drejtën, për:

a) një përfitim sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit, Kanadaja do të konsiderojë një periudhë të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar periudhën e banimit në Kanada;

b) një përfitim, bazuar në Planin Kanadez të Pensioneve, Kanadaja do të njohë një vit kalendarik që përfshin të paktën 90 ditë dhe që janë periudha të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar si një vit kalendarik i vlefshëm sipas Planit Kanadez të Pensioneve.

3. Për të përcaktuar të drejtën për një përfitim për pleqëri, invaliditet apo familjar, bazuar në legjislacionin shqiptar:

a) Shqipëria do të njohë një vit kalendarik që është periudhë e vlefshme sipas Planit Kanadez të Pensioneve si 12 muaj që janë të vlefshëm sipas legjislacionit shqiptar;

b) Shqipëria do të njohë një periudhë gjatë të cilës është paguar një përfitim invaliditeti bazuar në Planin Kanadez të Pensioneve si periudhë e vlefshme sipas legjislacionit shqiptar, nëse ajo periudhë e pagesës së përfitimit të invaliditetit nuk mbivendoset me një periudhë të vlefshme bazuar në Planin Kanadez të Pensioneve;

c) Shqipëria do të njohë një periudhë të vlefshme bazuar në Aktin e Sigurimeve për të Moshuarit të Kanadasë, si periudhë e vlefshme sipas legjislacionit shqiptar, nëse ajo periudhë e vlefshme sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit nuk mbivendoset me një periudhë të vlefshme sipas Planit Kanadez të Pensioneve ose si një periudhë gjatë të cilës është paguar një përfitim invaliditeti sipas Planit Kanadez të Pensioneve.

#### Neni 13

### **Periudhat e plotësuara sipas programit të një shteti të tretë**

Nëse një person nuk ka të drejtë për një përfitim bazuar në periudhat e vlefshme sipas legjislacionit të Palëve, të bashkuara në përputhje me nenin 12, Palët do të përcaktojnë të drejtën e atij personi për përfitim duke mbledhur këto periudha dhe periudhat e vlefshme të plotësuara sipas programit të një shteti të tretë me të cilin të dyja vendet janë të lidhura me instrumente të mbrojtjes shoqërore që parashikojnë bashkimin e periudhave.

#### Neni 14

### **Periudha minimale e bashkimit**

Nëse totali i periudhave të vlefshme sipas legjislacionit të një pale është më pak e 12 muaj dhe nëse, duke marrë parasysh vetëm këto periudha të vlefshme, ky person nuk ka të drejtë për një përfitim sipas legjislacionit të saj, asaj Pale nuk i kërkohet t'i paguajë atij personi përfitime për ato periudha. Megjithatë, Pala tjetër do të marrë në konsideratë këto periudha të vlefshme për të përcaktuar nëse ky person ka të drejtë për një përfitim bazuar në legjislacionit e asaj pale në përputhje me nenet 12 dhe 13.

## KAPITULLI 2

### PËRFITIMET SIPAS LEGJISLACIONIT TË KANADASË

#### Neni 15

### **Përfitimet sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit**

1. Nëse një person ka të drejtë për një pension ose ndihmë financiare sipas Aktit të Sigurimeve për të Moshuarit, bazuar vetëm në dispozitat e bashkimit të kapitulli 1, Kanadaja do të llogarisë shumën e pensionit ose ndihmës financiare të pagueshme për atë person bazuar vetëm në periudhat e rezidencës në Kanada, të cilat janë identifikuar në përputhje me atë Akt.

2. Paragrafi 1, zbatohet, gjithashtu, për një person jashtë Kanadasë, i cili do të ketë të drejtën për një pension të plotë në Kanada, qoftë edhe sikur ky person të mos kishte banuar në Kanada

për periudhën minimale të kërkuar nga Akti i Sigurimeve për të Moshuarit për pagesë të një pensioni jashtë Kanadasë.

3. Kanadaja do t'i paguajë një pension, të bazuar në Aktin e Sigurimeve për të Moshuarit, një personi i cili është jashtë Kanadasë, vetëm nëse periudhat e banimit të atij personi, të bashkuara në përputhje me kapitulli 1, janë të paktën të barabarta me periudhën minimale të rezidencës në Kanada, të kërkuar nga Akti i Sigurimeve për të Moshuarit për pagesë të një pensioni jashtë Kanadasë.

#### Neni 16

### **Përfitimet sipas Planit Kanadez të Pensioneve**

Nëse një person ka të drejtë për një përfitim bazuar vetëm në dispozitat e bashkimit të kapitullit 1, Kanadaja do të llogarisë shumën e përfitimit të pagueshme për atë person në këtë mënyrë:

a) pjesa e përfitimit e lidhur me të ardhurat përcaktohet në përputhje me dispozitat e Planit Kanadez të Pensioneve, bazuar vetëm në të ardhurat e llogaritshme për pension sipas këtij Plani;

b) pjesa fikse e përfitimit llogaritet paraprakisht duke shumëzuar:  
vlerën e pjesës fikse të përfitimit, të përcaktuar në përputhje me Planin Kanadez të Pensioneve;

me

pjesën që përfaqëson raportin e periudhave të derdhjes së kontributeve të Planit Kanadez të Pensioneve me periudhën minimale kualifikuese të kërkuar sipas këtij Plani për të krijuar të drejtën për këtë përfitim. Kjo pjesë nuk duhet të kalojë vlerën një.

#### KAPITULLI 3

### **PËRFITIMET SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**

#### Neni 17

### **Llogaritja e shumës së përfitimit të pagueshëm**

1. Nëse një person ka të drejtë për një përfitim, bazuar vetëm në dispozitat e bashkimit të kapitullit 1, Shqipëria do të përcaktojë shumën e përfitimit të pagueshëm atij personi në mënyrën e mëposhtme:

a) institucioni kompetent llogarit shumën teorike të përfitimit përkatës, sikur të gjitha periudhat e vlefshme të plotësuara sipas legjislacionit të parashikuar nga legjislacioni i të dyja Palëve, të jenë të plotësuara ekskluzivisht sipas legjislacionit shqiptar;

b) institucioni kompetent llogarit atëherë shumën përkatëse, bazuar në shumën e përcaktuar sipas nënparagrafit "a", në raport me kohëzgjatjen e periudhave të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar në raport me kohëzgjatjen e të gjitha periudhave të vlefshme në përputhje me nënparagrafin "a".

2. Nëse periudhat e vlefshme të bashkuara në përputhje me parashikimet e kapitullit 1 tejkalojnë periudhat e vlefshme të kërkuara për një pension të plotë pleqërie, invaliditeti ose familjar, institucioni kompetent do të llogarisë përfitimin duke marrë parasysh periudhën maksimale të kërkuar për një pension të plotë pleqërie, invaliditeti ose familjar në vend të shumës së periudhave të vlefshme sipas legjislacioneve përkatëse të të dyja vendeve.

#### PJESA IV

### **DISPOZITA ADMINISTRATIVE DHE TË NDRYSHME**

#### Neni 18

## **Rregullorja administrative**

1. Palët, nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente, do të përfundojnë një rregullore administrative e cila përcakton masat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët, nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente, do të përcaktojnë agjencitë e tyre ndërlidhëse në rregulloren administrative.

### Neni 19

#### **Shkëmbimi i informacionit dhe ndihma e ndërsjellë**

1. Pala do t'i:

a) komunikojë Palës tjetër, në masën që ja lejojnë ligjet e veta, çdo informacion të nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe legjislacionit të saj;

b) ofrojë ndihmë Palës tjetër për të përcaktuar se kur një person ka të drejtë për një përfitim, ose të përcaktojë shumën e përfitimit që personi ka të drejtë të marrë, nëse do të zbatonte legjislacionin e saj;

c) komunikojë pa vonesë Palës tjetër të gjithë informacionin në lidhje me masat që ajo ka marrë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje ose rreth ndryshimeve në legjislacionin e saj dhe që ndikojnë në mënyrën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila Palë do të ofrojë ndihmën e përmendur në paragrafin 1(b) pa pagesë, në përputhje me çdo dispozitë në rregulloren administrative sipas nenit 18, për rimbursimin e disa llojeve të shpenzimeve.

3. Me përjashtim të rasteve kur hapja e informacionit kërkohet nga ligjet e njëres Palë, çdo informacion rreth një personi që transmetohet nga njëra Palë tek Pala tjetër në përputhje me këtë marrëveshje, do të jetë konfidencial dhe mund të përdoret vetëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe legjislacionit. Një Palë nuk mund të hapë informacionin e marrë nga Pala tjetër tek një person, organ apo vend i tretë, me përjashtim të rasteve, kur:

a) Pala tjetër është njoftuar për hapjen e informacionit;

b) Pala tjetër jep pëlqimin për hapjen e informacionit; dhe

c) informacioni lëshohet vetëm për të njëjtin qëllim për të cilin është lëshuar fillimisht nga Pala tjetër.

### Neni 20

#### **Përjashtimi ose reduktimi i tarifave**

1. Nëse legjislacioni i një Pale parashikon se një person është i përjashtuar nga pagesa e plotë apo një pjesë e tarifave ligjore, konsullore ose administrative për një certifikatë apo dokument të kërkuar, për të zbatuar atë legjislacion, i njëjti përjashtim zbatohet për cilëndo tarifë ligjore, konsullore ose administrative për një certifikatë ose dokument të kërkuar për të zbatuar legjislacionin e Palës tjetër. Për Kanadanë, një person nuk përjashtohet nga pagesa e tarifës për një raport mjekësor që kërkohet nga Shqipëria vetëm për të mbështetur një pretendim për përfitim sipas legjislacionit shqiptar.

2. Dokumentet zyrtare të kërkuara për të zbatuar këtë marrëveshje nuk kanë nevojë për legalizim nga autoritet diplomatike ose konsullore.

### Neni 21

#### **Komunikimi gjuhësor**

Palët mund të komunikojnë drejtpërdrejt me një-tjetrën në secilën gjuhë zyrtare të çdo Pale.

### Neni 22

## **Paraqitja e një kërkesë, njoftimi ose apeli**

1. Nëse kërkesa, njoftimi ose apeli në lidhje me të drejtën për shumën e një përfitimi që duhej të ishte paraqitur te njëra Palë, brenda një periudhe të caktuar, por që është paraqitur brenda po asaj periudhe te Pala tjetër, Pala e parë do ta trajtojë sikur kërkesa, njoftimi ose apeli të ishte paraqitur te kjo Palë brenda periudhës së caktuar. Data e paraqitjes së kërkesës, njoftimit dhe apelit Palës tjetër konsiderohet të jetë data e paraqitjes së Palës së parë.

2. Palët konsiderojnë, se data kur është paraqitur kërkesa për përfitim sipas legjislacionit të njëres Palë të jetë sikur të ishte data e paraqitjes së kërkesës për përfitimin korrespondues sipas legjislacionit të Palës tjetër, nëse personi ofron informacion në kohën e aplikimit, duke përcaktuar se janë përmbushur periudhat e kërkuara sipas legjislacionit të Palës tjetër. Kjo nuk është e vlefshme për një kërkesë të paraqitur para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ose kur personi kërkon që kërkesa e tij për përfitim sipas legjislacionit të Palës tjetër të shtyhet.

3. Pala tek e cila është paraqitur një kërkesë, njoftim ose apeli sipas paragrafëve 1 dhe 2 do ta transmetojë atë pa vonesë te Pala tjetër.

### **Neni 23**

#### **Pagesa e përfitimeve**

1.a) Kanadaja do ta paguajë një përfitim, në monedhën lirisht të konvertueshme, te cilido person që banon jashtë territorit të saj.

b) Në përputhje me legjislacionin e vet Shqipëria do të paguajë një përfitim, në monedhën e vet kombëtare te çdo person që banon jashtë territorit të saj.

2. Asnjëra nga palët nuk do të zbresë shuma për shpenzimet e veta administrative nga pagesat e përfitimeve.

### **Neni 24**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që lind në interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me frymën dhe parimet themelore të kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 25**

#### **Marrëveshjet me një provincë në Kanada**

Shqipëria mund të lidhë marrëveshje me ndonjë provincë në Kanada mbi çdo çështje të mbrojtjes shoqërore që është brenda juridiksionit të provincës, me kusht që marrëveshja të jetë e pajtueshme me këtë marrëveshje.

## **PJESA V**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 26**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Palët, për të përcaktuar të drejtën për përfitim dhe shumën e përfitimit në zbatim të kësaj marrëveshjeje, do të marrin në konsideratë çdo periudhë të vlefshme të përfunduar para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje nuk i jep asnjë personi të drejtën për të marrë pagesën e një përfitimi për një periudhë para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

3. Pala do të paguajë një përfitim të ndryshëm nga përfitimi në shumë totale, për rastet që kanë ndodhur para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

4. Për qëllime të nenit 7, nëse përjashtimi i një personi fillon para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, data më e hershme që do të merret në konsideratë nga Palët si fillim i përjashtimit është data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 27

### **Kohëzgjatja dhe ndërprerja**

1. Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një kohë të pakufizuar. Secila Palë mund ta ndërpresë atë në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër 12 muaj para me shkrim, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

2. Nëse njëra Palë ndërpret këtë marrëveshje, personi ka të drejtën për çdo përfitim tashmë të fituar sipas kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje vazhdon të ketë efekt në lidhje me çdo person që ka aplikuar për një përfitim para ndërprerjes së saj dhe i cili do të kishte marrë një përfitim nëse kjo marrëveshje nuk do të ishte ndërprerë.

3. Të dyja Palët do të vazhdojnë të zbatojnë pjesën II të kësaj marrëveshjeje për përjashtimin që fillon para ndërprerjes së kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 28

### **Hyrja në fuqi**

Secila Palë, me notë diplomatike, do të njoftojë Palën tjetër, se ajo e ka përfunduar procedurën e brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të katërt pas muajit në të cilin është marrë nota e dytë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar për sa më sipër nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në Otava, sot, më 30 prill 2019, në gjuhët shqipe, angleze dhe frënge, ku secili version është njëllë autentic.

Për Republikën e Shqipërisë:

Për Kanadanë:

---

---